Kronikë

Akuzohet për atentatin ndaj ish-prokurorit Ndoja dhe për armë pa leje, lihet në burg Ramazan Rraja

Gjykata e Posaçme ka caktuar vazhdimin e masës 'arrest me burg' të dhënë në mungesë për Ramazan Rrajën. Atij përveç akuzave të mëparshme për atentatin ndaj ish-prokurorit Arjan Ndoja, i është shtuar edhe akuza e armëmbajtjes pa leje

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
21 Prill, 09:48 | **Përditësimi: 21 Prill, 11:36**

Gjykata e Posaçme ka caktuar vazhdimin e masës 'arrest me burg' të dhënë në mungesë për Ramazan Rrajën. Atij përveç akuzave të mëparshme për atentatin ndaj ish-prokurorit Arjan Ndoja, i është shtuar edhe akuza e armëmbajtjes pa leje.

Ramazan Rraja u arrestua pak ditë më parë në një lokal në zonën e Fushë-Krujës, ndërsa ishte me pistoletë në brez dhe fishek në fole gati për qitje. 30-vjeçari, një njeri i njohur i botës së krimit, nip i deputetit të PS-së, Rrahman Rrajës, ishte shpallur në kërkim për atentatin ndaj ish-prokurorit Arjan Ndoja dhe Rrumit të Shijakut.

LEXO EDHE:
Me këmishën gjysmë të hapur sheh kamerën e policisë 'në kokërr të syrit', del FOTO e arrestimit të Ramazan Rrajës

Ramazan Rraja, sipas policisë që nga momenti i shpalljes në kërkim nuk është larguar në asnjë moment në Dubai, por fshihej në trekëndëshin "Durrës-Lezhë -Tiranë".

Në momentin e arrestimit 30-vjeçari, shoqërohej edhe nga një njeri tjetër i botës së krimit, 39-vjeçari Louis Konomi alias Elton Llozhi, i shpallur në kërkim nga policia e Elbasanit për "Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie", të kryer në bashkëpunim.

Në 20 janar 2023 për atentatin ndaj Ndojës u arrestuan Genti Ndërjaku alias Akil Ndërjaku, Marsel Deçka, Endrit Sinani, Julian Pjetri dhe Bashkim Haxhija. Në 22 shkurt u arrestua në Abu Dhabi Amar Dritan Shkëmbit, në kërkim për atentatin janë edhe Julian Meçaj dhe Plaurent Dervishaj.

SPAK pretendon se Ramazan Rraja, bashkë me kushëririn e tij dhe persona të tjerë kanë organizuar ***atentatit ndaj prokurorit*** Arian Ndoja më 1 nëntor 2019. Në atentat mbeti i vrarë shoferi Andi Maloku, dhe u plagos Landi Muharremi "Rrumi i Shijakut" dhe ish-prokurori i Durrësit, Arjan Ndoja.

Ramazan Rraja është pyetur nga policia në muajin tetor të vitit të kaluar, edhe për vrasjen e trefishtë të mbikalimit të Fushë-Krujës, ku mes të vrarëve ishte kushëriri i Ervis Martinaj, Brilant Martinaj. Ramazan Rraja ka qenë në kërkim policor për vrasjen e trefishtë të mbikalimit të Fushë-Krujës për t'u marrë në pyetje, por në atë kohë nuk është gjetur. Në muajin tetor, pasi është kthyer nga jashtë është paraqitur personalisht dhe më pas është lënë i lirë.

Kujtojmë se Rraja po ashtu, në 2021 ***u shpall në kërkim pasi hyri i maskuar*** e i armatosur në një lokal. Ramazan Rraja po ashtu më herët u arrestua në Belgjikë dhe Gjermani për drogë.

M.Q./KT/Shqiptarja.com

TAG: Gjykata e Posaçme | Ramazan Rraja | arjan ndoja | spak | GJKKO

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
1 javë fushatë elektorale, cila palë ka kandidatët më të mirë?

PS | PD | Berisha-Meta

Lajme të tjera

Dështon për të tretën herë seanca në GJKKO për Inceneratorin e Elbasanit, shpallet në kërkim e akuzuara që duhet të ishte në 'arrest shtëpie'
20 Prill, 10:11



U kap me Ramazan Rrajën, kush është Elton Llozhi që ishte në kërkim! Kërcënoi me jetë biznesmenin që fitoi tenderin për lëndë drusore
20 Prill, 09:17



Arrestohet në Fushë-Krujë Ramazan Rraja, VIDEO nga momenti kur i vihen prangat me pistoletë në brez! Policia: S'ka qenë asnjëherë në Dubai
19 Prill, 20:53

Vrasja e Gentian dhe Nezir Beqirit, Ardian Çapja: Akuzat ndaj meje, të montuara nga prokuroria e Elbasanit! Jam i pafajshëm
19 Prill, 13:20

Trafikonin makina të vjedhura nga Kosova në Shqipëri, SPAK kërkon 71 vite burg për 7 të pandehurit! 12 vite për drejtuesin e grupit dhe 20 vite për 3 efektivët
19 Prill, 13:11

Frrok Çupi: Drejtësia e 're' po krijon një fron ku rrinë 'të paprekshëm' Sali Berisha dhe Ilir Meta
Frrok Çupi
19 Prill, 09:39

Abuzimi me tenderin 322 mln lekë, Apeli i GJKKO konfirmon masat për ish-kryebashkiakun e Bulqizës dhe 8 ish-zyrtarë! Lefter Alla në spitalin e burgut
14 Prill, 15:59

Autori i vrasjes së Behar Sofisë, Ernejt Shyti 'zbërthehet' në GJKKO: Vrasja për hasmëri! E ndoqa për 28 ditë! Do merrja 5 mln lekë
Keti Banushi
14 Prill, 14:03

Në burg për abuzim me tenderin 322 mln lekë, Lefter Alla shtrohet në spital! Kërkon masë më të butë sigurie
14 Prill, 11:04

Bashkëpunim kundër grupeve kriminale në Amerikën e Jugut, Dumani dhe Kraja takim në Argjentinë me prokurorët e EUROJUST dhe EUROPOL
14 Prill, 10:27

'Non-grata' për Berishën shpjegon paratë për fushatën dyvjeçare! Pse hesht Drejtësia?
Ardit Rada
14 Prill, 08:41

SPAK bën bilancin për muajin mars 2023: Nën hetim 18 persona për korrupsion dhe krim të organizuar! U sekuestruan 259 mijë euro
13 Prill, 09:34

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje